




Financuar nga
Bashkimi Evropian

R A P O R T

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit, 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit

KOMISIONI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

**Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit
nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit
dhe Ligjit, 08/L-040 për ndryshimin
dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156
për Kontrollin e Duhanit**



DEKLARATË MOHIMI: Ky raport është përgatitur nga Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me mbështetje të Demokraci Plus (D+). Kontributi i D+ është dhënë në kuadër të projektit “Qeverisje e mirë: prokurim publik dhe politik-bërje e avancuar” financuar nga Bashkimi Evropian (BE).

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe D+ dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Përmbajtja

I. Hyrje.....	7
II. Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit	8
III. Metodologjia	10
IV. Takimet dhe vizitat.....	11
V. Raportimet në Mbledhjet e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....	14
VI. Zbatueshmëria e ligjit.....	15
VII. Konkluzionet	19
VIII. Rekomandimet.....	20

Anëtarët e Komisionit për Shëndetësi:

1. Fatmire KOLLÇAKU	G/P-LVV, Kryetare,
2. Armend ZEMAJ	G/P-LDK, Zëvendëskryetar i parë,
3. Labinotë DEMI- MURTEZI	G/P-VV, Anëtare,
4. Bekim HAXHIU	G/P-PDK, Anëtar,
5. Haxhi AVDYLI	G/P-VV, Anëtar,
6. Mirsad SHKRETA	G/P-VV, Anëtar,
7. Burim META	G/P-VV, Anëtar,
8. Shemsedin DRESHAJ	G/P- AAK, Anëtar,
9. Floretë ZEJNULLAHU	G/P-PDK, Anëtare,
10. Samra ILIJAZ	G/P- MULTIETNIK, Anëtare

Stafi mbështetës:

- Shpresë Ramosaj - Haxhijaj, Koordinatore e Komisionit;
- Besim Haliti, Zyrtar i fushës.

I. Hyrje

Duke u bazuar në *Nenin 99 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Kosovës, ka kompetencë të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve. Për të ushtruar këtë kompetencë, komisioni bën kontrolle, hulumtime dhe analiza mbi efektivitetin e ligjeve në fuqi, paraqet propozime për masat konkrete që duhen të ndërmerren, ushtron kontroll të punës së ministrisë dhe organeve përkatëse rreth zbatimit të ligjeve dhe raporton para kuvendit për nivelin e zbatimit të ligjeve.

Lufta kundër duhanit është një sfidë me të cilën përballen pothuajse të gjitha shtetet. Pasojat e përdorimit të duhanit janë të shumta, ato cenojnë jo vetëm shëndetin e njerëzve, por kanë ndikime negative për mjedisin dhe shoqërinë në përgjithësi. Konsumimi i duhanit prek të gjitha grup-moshat, e në veçanti grup-moshat e reja.

Mungesa e statistikave zyrtare dhe hulumtimeve të thelluara në këtë fushë, shihet si pengesë në identifikimin e shkaqeve të problemit, për të cilin duhet planifikuar masa dhe veprime të strukturuar. Që nga nxjerrja e Ligjit për Kontrollin e Duhanit, masat kufizuese për duhanin nuk kanë gjetur zbatim të plotë. Prandaj, qëllimi i këtij raporti është që të kemi një pasqyrë reale për zbatimin e ligjit, në mënyrë që të propozohen masat e duhura ligjore dhe administrative për arritjen e standardeve mbi kontrollin e pirjes së duhanit.

Baza ligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, duke u bazuar në *nenin 99. të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës*.

Për këtë qëllim, komisioni formoi një grup punues, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë do të merret me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të komisionit të parapara me *nenin 99 të rregullores*, Komisioni në mbledhjen e mbajtur me 22 shkurt 2023 miratoi iniciativën për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.

Komisioni, pas përfundimit të punës disamujore në mbikëqyrje, ka përgatitur një raport në të cilin shprehet vlerësimi i tij për zbatimin e Ligjit për 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, duke përfshirë edhe rekomandimet në lidhje me masat që duhet ndërmarrë për përmirësim të ligjit dhe zbatimit të tij.

Ky raport i dorëzohet Kryesisë së Kuvendit, me kërkesën për debat, dhe miratim të tij në Kuvend. Pas miratimit nga Kuvendi, raporti i adresohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë, dhe do të publikohet në ueb faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

II. Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit

Korniza ligjore për Kontrollin e Duhanit ka filluar të ndërtohet që në vitin 2008, kur është aprovuar për herë të parë Ligjin Nr. 02/L-36 për Duhanin, i plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2010 përmes Ligjit 03/L-157. Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit u miratua në vitin 2013. Aktualisht, në fuqi është Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-040 të aprovuar në vitin 2022.

Për zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit janë nxjerrë dy udhëzime administrative nga Ministria e Shëndetësisë, si vijon:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2015 Mjediset pa tym duhani dhe vendosja e shenjave për ndalimin e pirjes së duhanit në hapësirat e mbyllura; dhe
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 Kushtet në hapësirat e lejuara për pirjen e duhanit.

Qëllimi i mbikëqyrjes të zbatimit të Ligjit për 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, është të vlerësohet ky ligj, si dhe të konstatohet niveli i zbatueshmërisë së tij në praktikë. Ky vlerësim është synuar të arrihet përmes takimeve dhe vizitave në terren, intervistat

me përfaqësues të institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës dhe akterë të fushës së duhanit nga institucionet përgjegjëse dhe sektori privat, me qëllim të marrjes së të dhënave në lidhje me funksionimin dhe zbatimin e këtij ligji, si dhe të vlerësojë nëse qeveria, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente, janë duke i përmbushur obligimet që dalin nga ky ligj. Sigurisht që reduktimi i numrit të duhanpirësve por edhe i kontrollit të duhanit nuk është një detyrë e lehtë, për shkak se njerëzit dhe institucionet përballen me të në çdo kohë dhe në forma të ndryshme. Në kushtet e zhvillimit të teknologjisë dhe digjitalizimit, kontrollimi i promovimit dhe reklamimit të produkteve të duhanit është mjaft i kufizuar. Sidoqoftë, qëllimi final i këtyre aktiviteteve dhe ndryshimeve të ardhshme ligjore është që të kemi një shoqëri të shëndoshë dhe ku duhanpirësi nuk ndihet komod gjatë konsumimit të duhanit, si-kurse është tani ku duhanpirësit e kanë të gjithë komoditetin dhe rehatinë për pirjen e duhanit kudo.

Qëllimet kryesore të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit janë:

- Vlerësimi i Ligjit 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit;
- Vlerësimi i përgjithshëm i zbatimit të Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit;
- Vlerësimi i shkallës së përmbushjes së obligimeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera në procesin e zbatimit të ligjit;
- Vlerësimi i nxjerrjes dhe zbatimit të akteve nënligjore nga Ministria, me qëllim të zbatimit të këtij ligji;
- Vlerësimi i efekteve dhe pasojave të mos zbatimit efikas të ligjit.

Bazuar në problemet e identifikuar, komisioni do të vendosë për inicimin apo rekomandimin për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji.

III. Metodologjia

Në funksion të realizimit të qëllimeve të sipërpërmendura, komisioni ka ndër-marrë hapat në vijim:

- Formimin e grupit punues nga anëtarët e komisionit.
- Identifikimin i institucioneve, autoriteteve dhe subjekteve relevante për zbatimin e ligjit.
- Vizitat në institucionet relevante qeveritare dhe në institucione tjera përgjegjëse për zbatim të ligjit.
- Mbledhjen, studimin dhe analizimin e dokumenteve relevante.

Mbledhja e informatave të nevojshme nga Komisioni është zhvilluar në disa faza:

- Mbledhja e informatave nga Ministria e Shëndetësisë.
- Mbledhja e informatave nga Inspektorati Sanitar.
- Mbledhja e informatave nga Shoqata e Gastronomëve të Kosovës.

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e datës 22 shkurt 2023, formoi Grupin Punues, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë do të merret me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Grupi Punues përbëhet nga:

- Haxhi Avdyli – kryesues
- Fatmire Kollçaku – anëtare
- Mirsad Shkreta - anëtar
- Armend Zemaj - anëtar
- Shemsedin Dreshaj - anëtar
- Floretë Zejnullahu - anëtare

Bazuar në mandatin e autorizuar nga komisioni, grupi punues për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, ka pasur autoritetin të zhvilloj aktivitetet e nevojshme me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të dhënave mbi nivelin e zbatimit të ligjit dhe në fund të përgatisë një raport përmbledhës të cilin do t'ia prezantoj komisionit për shqyrtim. Grupi punues gjatë hulumtimit është mbështetur me ekspertizë nga organizata e shoqërisë civile, Demokraci Plus (D+).

Gjatë periudhës: mars - qershor 2023, grupi punues ka realizuar disa takime

dhe vizita në terren. Gjithashtu, janë mbajtur takime të rregullta të grupit, qëllimi i të cilave ishte koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve. Vizitat dhe takimet e grupit punues në terren u përqendruan në institucionet relevante të cilat njëherit janë edhe zbatues të ligjit si: Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Sanitar dhe Shoqata e Gastronomëve.

IV. Takimet dhe vizitat

- Grupi punues ka mbajtur disa takime me qëllim të koordinimit dhe planifikimit të aktiviteteve të tij, dhe realizimit sa më të suksesshëm të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.
- Grupi punues ka realizuar disa takime dhe vizita me qëllim të zhvillimit të aktivitetit monitorues.
- Me 27 shkurt 2023, grupi punues ka miratuar planin e punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.
- Grupi punues fillimisht me datë 6 mars 2023, ka realizuar një takim me zëvendësministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Arsim Berisha, Sekretarin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Naim Bardiqi, Udhëheqës i Divizionit të komunikimit publik në Ministrinë e Shëndetësisë z. Faik Hoti, inspektoren e inspektoratit shëndetësor znj. Advie Mala dhe ud. Drejtorin e zyrës ligjore znj. Aferdita Hoxha.

Interesimi i grupit punues ishte rreth zbatimit të Ligjit 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, duke parashtrua disa pyetje nga kryesuesi i grupit punues deputeti Haxhi Avdyli, rreth pengesave në zbatimin e këtij ligji pasi vitet e fundit ka moszbatim në masë të madhe të ligjit sidomos nga lokalet e gastronomisë por edhe nga institucionet shtetërore ku nuk respektohet mos pirja e duhanit në ambiente të mbyllura. Kryetarja e Komisionit Fatmire Kollçaku, pyeti rreth nxjerrjes së akteve nënligjore që parashihen me ligj, rreth funk-

sionalizimit të Këshillit Ndërmintor për kontroll të duhanit dhe rreth fushatave sensibilizuese për pasojat e pirjes së duhanit. Komentet dhe pyetje rreth vështirësive në zbatimin e ligjit patën edhe deputetët Shemsedin Dreshaj dhe Floretë Zejnullahu.

Sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë z. Naim Bardiqi tha se viteve të fundit nuk është bërë sa duhet mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për disa arsye e që kanë qenë si kapacitetet shumë të ulëta të Inspektoratit Shëndetësor ku ky inspektorat ka vetëm 12 inspektorë por edhe situata me pandeminë COVID-19. E kemi vërejtur që ka nevojë për mbikëqyrje dhe zbatim të ligjit por është e nevojshme edhe amendamenti i ligjit apo hartimi i një ligji të ri dhe harmonizimi edhe me direktivën e BE-së. Duhet vetëm të dakordohemi se cila ministri do ta merr iniciativë që të filloj hartimin e koncept dokumentit e pastaj edhe të ligjit të ri. Shumë shpejt do të hartohet edhe koncept dokumenti prandaj edhe kjo mbikëqyrje dhe raporti që do të hartohet nga komisioni juaj do të shërben hartimit dhe zbatimit të këtij ligji.

Gjithashtu u tha se dy udhëzime administrative të parapara me ligj janë nxjerrë ndërsa një ende nuk është nxjerrë. Nuk ka funksionuar Këshilli Ndërmintor për Kontrollin e Duhanit por besoi shumë shpejt do ta marrim iniciativën dhe do të funksionalizohet.

Udhëheqës i Divizionit të komunikimit publik z. Faik Hoti njoftoi anëtarët e komisionit se zbatimi i ligjit nuk është respektuar në masë të madhe edhe nga mediat e sidomos kohëve të fundit një problem i madh ekziston edhe me ekspozimin në media në masë të madhe të cigareve elektronike. Sa i përket testeve të parapara me ligj ato kryhen në mënyrë të rregullt.

Inspektorja e inspektoratit shëndetësor znj. Advie Mala njoftoj që Inspektorati Shëndetësor e inspekton zbatimin e këtij ligji në institucionet shëndetësore dhe tha se në masë të madhe ky ligj zbatohet në këto institucione por në disa raste ka pasur edhe shkelje ku janë shqiptuar edhe 5 gjoba. Në kohën e fundit nuk ka pasur asnjë fushatë sensibilizuese për mos konsumim të duhanit qoftë në media apo në shkolla.

Zëvendësministri z. Arsim Berisha, dha zotimin para anëtarëve të komisionit që bashkë me ministrin dhe me organet kompetente do të angazhohen në zbatimin e këtij Ligji dhe do të punojnë edhe për funksionalizimin e Këshillit Ndërmintor për Kontrollin e Duhanit.

Në fund u konstatua se kjo mbikëqyrje dhe raporti që do hartohet do i jap impakt të duhur zbatimit të këtij ligji.

Grupi punues me datë 5 maj 2023 ka vizituar Agjencionin e Ushqimit dhe të veterinarisë ku është takuar me ud. Drejtorin ekzekutiv të Agjencionit z. Flamur Kadriu, me z. Arsim Arifi zv. Drejtor i drejtorisë së inspektoratit dhe me z. Ibrahim Tërshnjaku, shef në inspektoratin sanitar.

Interesimi i deputetëve ishte rreth mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit nga Inspektorati sanitar, për vështirësinë dhe të arriturat në zbatimin e ligjit 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.

Z. Flamur Kadriu njoftoi anëtarët e grupit punues që Inspektorati Sanitar në kuadër të Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë ka marrë disa hapa në zbatimin e këtij ligji dhe rezultatet janë të mira por jo të mjaftueshme për zbatimin në tërësi të ligjit. Ai njoftoi që inspektorati sanitar është përballur me disa vështirësi në zbatimin e këtij ligji por edhe në legjisacionin tjetër që mbikëqyrë ky inspektorati. Inspektorati ka kaluar nëpër disa vështirësi sidomos gjatë kohës së pandemisë kur angazhimi ka qenë shumë i madhe dhe ka pasur një numër shumë të vogël të inspektorëve. Tani situata është më mirë pasi edhe një numër i Inspektorëve Sanitar komunal ka kaluar në nivelin qendror të Inspektoratit Sanitar dhe tani inspektorati sanitar ka 49 inspektor sanitar. Lidhur me punën dhe hollësitë e zbatimit të ligjit do ti njoftoi anëtarët e grupit punues z. Ibrahim Tërshnjaku.

Z. Ibrahim Tërshnjaku njoftoi anëtarët e komisionit se megjithëse aktivitete që ka marrë inspektorati sanitar në zbatimin e këtij ligji prapë se prapë nuk ka arritur të zbatohet në masë të kënaqshme. Përveç numrit të vogël të inspektorëve sanitar vështirësi ka pasur edhe në disa aspekte tjera. Ligji ka qenë shumë i avancuar dhe i pa akceptueshëm për mentalitetin që ekziston në vendin tonë. Nuk ka pasur fushata të mjaftueshme vetëdijësuese si për popullatën ashtu edhe për lokalitetet afariste. Gjithashtu disa dispozita të ligjit janë të pa qarta dhe jo të harmonizuara mirë. Kemi vështirësi sidomos në zbatimin e nenit 12, dhe te përkufizimi i hapësirës së mbyllur.

Kemi një numër të vogël të inspektorëve dhe 20 prej tyre kanë moshën mbi 60 vjet që paraqet vështirësi shtesë në punën tonë. Inspektorati Sanitar mbikëqyr disa ligje dhe ka vëllim të madh të punës. Sa i përket zbatimit të ligjit të duhanit këtë vit kemi shqiptuar diku 375 gjoba. Kërkojmë që në

zbatimin e këtij ligji të kemi përkrahje dhe ndihmë edhe nga inspektorati tjera.

Grupi punues me datë 16 maj 2023 ka takuar përfaqësuesit e shoqatës së gastronomëve të Kosovës z. Petrit Kllokoç - kryetar dhe z. Arian Vranica - sekretar i shoqatës. Interesimi i anëtarëve të grupit punues ishte se me cilat vështirësi po përballen gastronomët gjatë zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

Z.Kllokoçi njoftoj anëtarët e grupit punues se ligji ka qenë shumë i avancuar dhe ka hasur në pengesa në zbatim. Nuk ka pasur fushata vetëdijësuese dhe inspektimi është dashtë të fillohet që nga shenjzimi dhe shitja në markete te personat më të ri se 18 vjet e deri te lokalet e gastronomisë. Problemin thelbësor e kemi te definimi i hapësirave të hapura te tarracat ku neni që definojnë këto hapësira është mjaft i paqartë.

Z. Vranica tha se edhe udhëzimi administrativ nuk është në përputhje me ligjin dhe definimi i hapësirave të hapura po paraqet vështirësi dhe pabarazi në mes bizneseve. Gjithashtu kërkojmë të ketë fuqizim të Inspektoratit Sanitar dhe shtim të numrit të inspektorëve në mënyrë që inspektimi të shtrihet në mënyrë të barabartë e jo disa lokale të kenë inspektime te vazhdueshme e disa fare.

V. Raportimet në Mbledhjet e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, për aktivitetet e zhvilluara të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, në mbledhjet e komisionit ka raportuar deputeti Haxhi Avdyli, raportues i grupit, ku ka prezantuar të arriturat në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.

Në të gjitha fazat e procesit të mbikëqyrjes së ligjit, grupi punues është mbështetur nga stafi i komisionit.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, grupi punues, ka arritur të mbledhë të dhëna të mjaftueshme mbi zbatueshmërinë e këtij ligji. Në bazë të të gjeturave nga takimet, grupi punues, ka vlerësuar nivelin e zbatimit të ligjit, ka identifikuar problemet dhe në formë të rekomandimeve ka propozuar masat konkrete që duhet të ndërmerren për të ndryshuar gjendjen.

VI. Zbatueshmëria e ligjit

Ligji për Kontrollin e Duhanit ka përcaktuar një numër masash të cilat duhet të ndërmerren për të mbrojtur shëndetin publik, për të parandaluar pasojat shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore të cilat shkaktohen si rezultat i konsumimit të duhanit. Përgjegjësia për zbatimin e këtij ligji është shumë sektoriale si nga sektori publik, privat ashtu edhe nga individët. Duke qenë përgjegjësi e shpërndarë, domosdo nevojitet koordinim dhe bashkërendim i mirëfilltë i tyre, për të zvogëluar konsumimin e duhanit dhe kontrolluar cilësinë e produkteve në treg. Për këtë qëllim, varësisht prej çështjeve specifike, ligji i ndan edhe detyrat e institucioneve përkatëse. Në mesin e shumë çështjeve, ligji përcakton aspekte të kontrollit që kanë të bëjnë me: paketimin dhe shenjzimin e produkteve të duhanit, përbërësve, testimin e tyre, reklamimin, promovimin, sponsorizimin, shitjen, mjediset ku mund të konsumohet, parandalimin, vetëdijesimin dhe edukimin.

- **Të arriturat nga koha e miratimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit**

Fillimisht me miratimin e ligjit ka pasur një zbatim të kënaqshëm dhe ka pas edhe rezultate. Më vonë për shkak të numrit të vogël të inspektorëve dhe situatës me pandemi ka pasur rënie në zbatimin e ligjit dhe fare pak është zbatuar.

Tani me angazhimin e Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Faton Peci dhe angazhimin e Inspektoratit Sanitar, ka filluar një fazë e zbatimit të ligjit ku ka ndikuar në masë të madhe të ketë zbatim edhe në institucione, edhe në lokale të gastronomisë. Përpjekjet

dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit po vazhdojnë.

- **Sfidat në zbatimin e Ligjit dhe të gjeturat**

Ky ligj ka hasur edhe në disa pengesa dhe sfida për tu zbatuar.

Sfidat dhe të gjeturat kryesore kanë qenë:

- Numri i vogël i Inspektorëve Sanitar dhe mos fuqizimi i këtij inspektorati.
- Nuk ka qenë funksional Këshilli Ndërmintor për Kontrollin e Duhanit i paraparë me ligj.
- Nuk është nxjerrë një udhëzim administrativ i paraparë në ligj.
- Ligji nuk është i harmonizuar me direktivat e BE-së.
- Konsumimi, shitja dhe reklamimi dhe i produkteve elektronike të duhanit nuk ka qenë i definuar qartë me ligj.
- Nuk ka pas mbikëqyrje të duhur të reklamimit të cigareve në media sidomos të atyre elektronike edhe pse është e ndaluar me ligj.
- Ka paqartësi me definicioni të hapësirës së mbyllur.
- Neni 12 është i paqartë dhe ka vështirësi në zbatim.

A. Paketimi dhe shenjzimi

Në Kosovë, Ligji për Kontrollin e Duhanit, në nenin 6 ka përcaktuar vërejtjet dhe shenjzimet që duhet t'i përmbajnë produktet e duhanit. Në mes tjerash, paragrafi 13 i nenit 6 thekson që "çdo njësi e paketimeve të produkteve të duhanit duhet të ketë fotografi që dekurajojnë përdorimin e produkteve të duhanit të përcaktuar me akt nënligjor nga ministria". Aktualisht kjo dispozitë nuk është duke u zbatuar në paketimet e produkteve të duhanit, ngase pothuajse të gjitha produktet e ofruara në treg përmbajnë vetëm pjesën tekstuale të paralajmërimit për rreziqet e duhanit të përcaktuara në ligj, ndërsa nuk përmbajnë fotografi për rreziqet e duhanit.

B. Reklamimi, promovimi dhe sponsorimi i produkteve të duhanit

Reklamimi, sponsorizimi dhe promovimi janë tri fromat kryesore të strategjive të marketingut. Në Kosovë, Ligji për Kontrollin e Duhanit në nenin 8 ka vendosur norma që ndalojnë reklamën, promovimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit. Në kuptim të masave kontrolluese, dispozitat ligjore kanë ndaluar reklamën, promovimet dhe sponsorizimet vendore dhe ndërkufitare të ngjarjeve dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me duhanin.

Gjithashtu, ligji ndalon që personat drejtpërdrejtë apo tërthorazi: 1) Të nxisin reklamimin, promovimin dhe sponsorizimin; 2) Të prodhojë, publikojë, apo të ofrojë qasje në çfarëdo reklame, promovimi, ose sponsorimi; 3) Të përfshihet apo të marrë pjesë në ndonjë reklamë, promovim, ose sponsorim si media apo organizator i ngjarjeve, person i famshëm apo pjesëmarrës tjetër, si pranues i çfarëdo kontributi sponsorues, ose si ndërmjetës që lehtëson ndonjë kontribut të tillë duke përfshirë edhe çdo komunikim komercial, veprim apo praktikë që promovon apo mund të promovojë ndonjë prodhues të duhanit, shitës me shumicë, ose importues drejtpërdrejtë apo indirekt. Përveç këtyre, janë të ndaluara reklamën, promovimet dhe sponsorimet e duhanit të sponsoruara dhe të iniciuara nga ndonjë shtetas i huaj apo vendi tjetër, në territorin e Republikës së Kosovës.

C. Shitja e produkteve të duhanit

Shitja e produkteve të duhanit është aspekt tjetër që zë vend të veçantë në Ligjin për Kontrollin e Duhanit. Me ligjin aktual, shitja është e kufizuar në raport me vendet, mënyrën e shitjes dhe personave që u lejohej të blejnë. Në nenin 9, ligji ka rregulluar se shitja nuk mund të bëhet në institucione shëndetësore dhe arsimore, përkatësisht oborret apo hapësirat e tyre. Po ashtu përcaktohet ndalimi i shitjes së produkteve të duhanit në të gjitha llojet e objekteve sportive, rekreative dhe kulturore, përfshirë edhe oborrit në administrim të institucionit. Krahas vendeve ku ndalohet shitja e produkteve të duhanit, ligji ka rregulluar edhe mënyrën e shitjes së këtyre produkteve, duke nënvizuar që produktet e duhanit të vendosen në pjesë të mbyllura, përkatësisht ka ndaluar vendosjen e tyre në pjesë të dukshme në vendet ku shiten, me përjashtim të momentit të blerjes. Ndër të tjera, Ligji për Kontrollin e Duhanit ka përcaktuar ndalesën që produktet e duhanit të vendosen në vendet ku konsumatori mundet vetë të shërbehet me duhan, derisa shitjen e tyre përmes aparateve të shitjes e ka lejuar vetëm në hapësirat e mbyllura të objekteve hoteliere, të cilat i plotësojnë kushtet sipas këtij ligji.

Po ashtu, një dispozitë e veçantë e nenit 9 të ligjit ka përcaktuar që “produktet e duhanit mund të shiten vetëm në pako të mbyllura”. Edhe kjo çështje përbën problem në vete, ngase ka shumë markete të cilat shesin cigare jashtë paketi-meve të tyre, duke i bërë të mundur qasjen personave më të lehtë në këto produkte, e kryesisht të miturve.

D. Trajtimi i cigareve elektronike

Konsumimi, shitja, reklamimi dhe promovimi i produkteve elektronike të duhanit, vazhdon të jetë një çështje problematike e cila mbetet si rezultat i paqartësive ligjore, respektivisht mungesës së rregullimit specifik të këtyre produkteve. Këto produkte aktualisht rregullohen sipërfaqësisht me Ligjin Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit në nenin 11, paragrafi 4 që thotë” Ndalesat e pirjes së duhanit të përcaktuara në këtë nen do të aplikohen edhe në përdorimin e ndonjë pajisje që prodhon emisione të nikotinës apo ndonjë substance tjetër që rrjedh nga duhani, përveç nëse ajo pajisje është lejuar për përdorim nga ministria si terapi për zëvendësimin e nikotinës apo për qëllime tjera mjekësore”, e që sipas grupit monitorues nuk është e mjaftueshme.

Gjithashtu, neni 8 paragrafi 3, ka përcaktuar që ”ndalohet reklamimi i produkteve të cilat sipas këtij ligji nuk janë produkte të duhanit por me dukjen e tyre, emërtimin dhe qëllimin e përdorimit, nxisin përdorimin e produkteve të duhanit”. Në kuptim të kësaj dispozite, edhe cigaret elektronike kanë qëllim të njëjtë, konsumimin e tymit (avullit) apo nikotinës si përbërës kryesor i tyre, andaj dispozita e mësipërme për ndalimin e reklamimit të këtyre produkteve do duhej të vrente njësoj. Nga grupi monitorues është parë si problem mostrajtimi i cigareve elektrike me ligj, për shkak se të njëjtat përmbajnë komponentë të tilla si nikotina, e cila shkakton varësi dhe ka elemente të dëmshme për shëndetin.

E. Vetëdijesimi kundër pirjes së duhanit

Kontrolli i pirjes së duhanit është një çështje mjaft sfiduese pothuajse në çdo shtet. Mirëpo, masat e ndërmarra të deritanishme në Kosovë në vetëdijesimin dhe monitorimin nuk kanë rezultuar me sukses për arritjen e qëllimit për reduktimin e numrit të përdoruesve të duhanit, si dhe për respektimin e kufizimeve në konsumimin e duhanit në hapësirat publike të brendshme.

Institucionet kompetente duhet të organizojnë më shumë fushata vetëdijesuese sidomos në shkolla për dëmet që shkakton në shëndet pirja e duhanit.

F. Inspektimi dhe koordinimi institucional

Monitorimi apo inspektimet sipas Ligjit për Kontrollin e Duhanit janë përgjegjësi ndërinstitucionale. Varësisht nga specifikat e rregullimit dhe aspekteve që mbulon ky ligj, inspektimi është bartur në përgjegjësi të organizatës përkatëse, Përgjegjësia institucionale për zbatimin e këtij ligji i takon, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Pyltitarisë dhe Zhvillimit Rural - AUV, Ministrisë së Arsimit, Policisë, Komunave etj. Megjithatë, të gjithë trupës përgjegjëse ndërinstitucionale i mungon një organ ombrellë, i cili do të siguronte koordinimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve për monitorim dhe zbatim të ligjit. Në shumë raste shtrirja e përgjegjësisë sipas institucionet nuk është e qartë dhe mund të shihet si përgjegjësi e dyfishtë. Në të njëjtën kohë, numri i inspektorëve vlerësohet të jetë i pamjaftueshëm për të mbuluar kërkesat ligjore. Prandaj, meqenëse parashihet në ligjin aktual, duhet që të jetë funksional Këshilli Ndërmnistror për Kontrollin e Duhanit.

VII. Konkluzionet

Duke u bazuar në punën e bërë në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka arritur në disa konkluzione rreth zbatimit të ligjit.

Komisioni konkludon se: edhe pse fillimisht ka pasur progres në zbatimin e ligjit, pas një kohe ka pasur ngecje për shkak të mungesës së vullnetit për zbatim nga organet ligj zbatuese dhe numrit të vogël të inspektorëve, nuk ka qenë funksional Këshillin Ndërmnistror për kontroll të duhanit dhe nuk ka pasur kapacitete të mjaftueshme për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, ka pasur vështirësi e paqartësi të vetë dispozitat ligjore në definimin e hapësirave të mbyllura, nuk ka pasur fushata të mjaftueshme vetëdijesuese për mos pirje të duhanit.

Gjithashtu korniza ligjore aktuale nuk i trajton cigaret elektronike apo pajisjet

tjera me avull, kështu që konsumimi i tyre është lehtë i mundshëm edhe brenda hapësirave të mbyllura të lokaleve. Kjo ka ndikuar që konsumimi i produkteve elektronike të duhanit në Kosovë është rritur në masë të madhe kohëve të fundit.

Përveç vështirësive në zbatim komisioni konkludon që tre muajt e fundit ka një rritje të kënaqshme të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit nga organet kompetente dhe ka hapa konkret në fuqizimin e Inspektoratit Sanitar dhe është konstituar Këshilli Ndërmnistror për kontrollin e duhanit.

VIII. Rekomandimet

1. Ministria e Shëndetësisë, të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Ligj për Kontrollin e Duhanit ku do të përfshihen definimi i saktë i hapësirave të hapura dhe të mbyllura, të trajtohet përdorimi i cigareve elektronike dhe produkteve tjera me avull, si dhe të bëhet harmonizimi me direktivat e BE-së.
2. Të miratohen aktet nënligjore të cilat ende nuk janë miratuar, siç parashihet me ligj.
3. Të jetë funksional Këshilli Ndërmnistror për Kontrollin e Duhanit.
4. Të rritet numri i inspektorëve sanitar, shëndetësor, të rritet numri i inspektimeve dhe të bëhet koordinimi me inspektoratet tjera që të bëhet një mbikëqyrje e plotë e zbatimit të ligjit.
5. Gjatë plotësim-ndryshimit të Ligjit të ketë bashkëpunim edhe me palët që afektohen nga ligji dhe me OJQ-të që merren me këtë fushë.
6. Gjatë plotësim-ndryshimit të legjislacionit aktual për duhanin, të parashihen në detaje cigaret elektronike dhe produktet tjera me avull, forma e konsumimit, paketimi, reklamimi dhe trajtimi i tyre i ligjshëm.
7. Të organizohen më shumë fushata vetëdijësuese që inkurajojnë individët të mos pinë duhan apo ndërpresin pirjen e duhanit.
8. Organet kompetente të mbikëqyrin dhe sanksionojnë reklamimin apo ekspozimin në mediat e shkruara dhe elektronike të produkteve të duhanit.

9. Të rritet kontrolli te mënyra e shitjes dhe blerjes së produkteve të duhanit dhe te personat të cilët kanë të drejtën e blerjes.
10. Të rritet kontrolli te konsumimi i duhanit në hapësira në administrim të institucioneve edukative-arsimore, në afërsi të hyrjeve/daljeve të hapësirave publike, hyrjeve/daljeve të hapësirës së punës dhe në hyrjeve/daljeve të institucioneve shëndetësore, vendet e lojërave për fëmijë, stadium, arenë, apo hapësirë për çfarëdo shfaqje.

Rekomandim shtesë:

- Ministria e Shëndetësisë duhet t'i raportoj Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për nivelin e zbatimit të ligjeve. Kjo përgjegjësi e ministrisë buron nga Rregulla 99, paragrafi 7 dhe 9, i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prishtinë më: 7 korrik 2023

Kryetarja e Komisionit

Fatmire Kollçaku



Financuar nga
Bashkimi Evropian

